

C.nr.58/2017

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS** si kontestimore e përbërë nga kolegji gjyqësor: Faton Ademi kryetar dhe anëtarëve porotë: Kimete Fejza dhe Enver Ramaxhiku në çështjen juridike të propozuesit: [ ] nga [ ], rr. "1" p.nr., dhe kundërpropozueses: [ ] nga [ ], rr. "1" p.nr., për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 20.06.2017 bie këtë:

### AKT GJYKIM

- **ZGJIDHET** martesa e lidhur në mes të propozuesit [ ] i lindur me [ ] në [ ], me vendbanim në rr. "1" nga [ ] i ati [ ], nëna [ ] dhe kundërpropozueses [ ] nga [ ] tani me vendbanim në Rr. "1" nga [ ] i ati [ ], e lindur me [ ] nga [ ] i ati [ ] dhe e ëma [ ], e lidhur në zyrën e gjendjes civile në [ ] me datë: 10.10.2013 me numrin rendor [ ] dhe numër të referencës: RM/ [ ] në bazë të propozimit të përbashkët për zgjidhje të martesës me marrvëshje konform nenit 68 dhe 69 të Ligjit për familjen i Kosovës.
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### Arsyetim

Procedura ka filluar me anë të padisë të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 08.02.2017.

Pas shqyrtimit të padisë, gjykata ka caktuar seancë me datë 20.06.2017.

Pasi që në seancë paditësja nuk e kundërshtoi padinë, padia e paditëses u konsiderua si propozim i përbashkët i palëve ndërgjyqëse për zgjidhje të martesës në bazë të marrëveshjes.

Procedurën e pajtimit në mes të palëve gjykata e përfundoi në seancë për arsye se u pa qartë se një pajtim në mes të palëve ndërgjyqëse është i pamundshëm dhe i paarrtshëm.

Në seancë propozuesi deklaroi se: ne faktikisht jemi marrë vesh përmes familjeve që martesa në fjalë të zgjidhet, arsyet janë të cekura edhe në padi, mirëpo është interesi im që këtë ta formalizoi edhe në aspektin juridik. Unë hjeku dorë nga e drejta në ankesë dhe shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Propozuesja-kundërpropozuesja deklaroi se: Unë nuk e kundërshtoi padinë për shkurorëzim, por e kundërshtoi një pjesë të deklaratës së dhënë në padi

prova e zgjidhë me shkurorëzim sipas propozimit të përbashkët. Unë hjeku dorë nga e drejta në ankesë dhe shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Për vërtetimin sa më të plotë të gjendjes faktike, gjykata administroi këto prova: , certifikata e martesës me numër rendor , me numër të referencës Ref. RM/ e datës 26.01.2017.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se propozuesit kanë lidhur martesë në mes tyre me datë: 10.10.2013 i cili këtë fakt vërtetohet në bazë të certifikatës së martesës.

Se palët ndërgjyqëse nuk kanë jetuar faktikisht së bashku edhe pse juridikisht kanë qenë të martuar, gjykata këtë fakt e vërteton në bazë të deklaratës së propozueses.

Pasi që palët ndërgjyqëse janë të ndarë qe një kohë të gjatë dhe se nuk kanë jetuar fare bashkë dhe se raportet bashkëshortore janë çrregulluar si rezultat i mosjetesës së përbashkët, prandaj ndarja faktike dhe çrregullimi i raporteve janë shkaqe që qojnë në shkurorëzim dhe gjykata nuk e pa të arsyeshme që të hetoi në shkaqe të shkurorëzimit.

Gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi vendosi duke u bazuar në dispozitat ligjore 68, 69 dhe 84 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata vendimin e mori konform nenit 450 të LPK-së.

Aktgjykimi bazohet në nenin 143, par.1 të LPK .

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.58/2017 të dt.20.06.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT- GJYQTARI**  
**Faton Ademi**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Ky aktgjykim bëhet i plotëfuqishëm ditën e nxjerrjes së të njëjtit pra me datë: 20.06.2017, pasi palët ndërgjyqëse kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.